




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.rks-gov.net/gjilan, tel.0280 320 781, 0280 320 782, 0280 321 482, 0280 321 486

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 39 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës 01. nr. 16-53125 të dt. 11.11.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 06.04.2012, merr këtë

V E N D I M

Mbi plotësimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha
Komunale 01. nr. 16 – 67245 për vitin 2012 të datës 27.12.2011

- I. Te neni 5 pas tarifës 3.32 të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale vihet titulli me këtë përmbajtje: **“Ekspozimi i pllakateve (panove) reklamuese në hapësira publike të mbyllura, në Palestrën e Sporteve “Bashkim Selishta – Petriti” dhe tarifa e re 3.33 me këtë përmbajtje si në vijim:**
 - a) Vendosja e reklamës në qendër të fushës (parket)-pozicioni 1 tarifë mujore fikse 100€;
 - b) Vendosja e reklamës në katërkëndëshat ne fushën e Basketbollit (parket)-pozicioni 2 tarifë mujore fikse 50€;
 - c) Vendosja e reklamës ne hapësirën e 6 metërshit të fushës së Hendbollit (parket)-pozicioni 3 tarifë mujore fikse 50 €;
 - d) Vendosja e reklamës në vijat fundore të fushës (parket)-pozicioni 4 tarifë mujore fikse 50€;
 - e) Vendosja e reklamës jashtë vijave të fushës (pano)-pozicioni 5 tarifë mujore për m^2 15 €;
 - f) Vendosja e reklamës rreth tribunave (pano)-pozicioni 6 tarifë mujore për m^2 15 €.
- II. Këto tarifa sipas pikës I të këtij vendimi duhet të inkorporohen në rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2012 dhe duhet të bëhet rirenditja e numrave të tarifave.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport, kurse mbikëqyrjen e bënë Kryetari i Komunës.

Kuvendi I Komunës,

IZMI ZEKA

01. nr. 16-38281
Gjilan, më 06.04.2012